

## Njoftimi Paraparak i Fituesit

**DATA E TRANSMETIMIT:** Ky Njoftim dërgohet me *email* në datë 10 Qershor 2025.

**Korporata:** Korporata e Investimeve Shqiptare  
**Projekti i Investimit:** Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore  
**Konkursi i projektimit:** Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit  
**Titulli i Kontratës:** Për rikonceptimin e rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitare, Vila Velipojë

Ky Njoftim Paraparak i Fituesit (Njoftim) ju njofton për vendimin tonë për të lidhur kontratën e mësipërme. Transmetimi i këtij Njoftimi fillon periudhën e ankimimit. Gjatë periudhës së ankimimit ju mund të:

- kërkoni një informim në lidhje me vlerësimin e propozimit tuaj dhe/ose
- të paraqesni një ankesë në lidhje me vendimin për lidhjen e kontratës.

### 1. Propozuesi i suksesshëm

<b>Emri:</b>	Shoqëria “Xhenis - SH”
<b>Adresë:</b>	Sheshi “2 Prilli”, Shkodër, Tiranë
<b>Vlera e ofruar:</b>	1,500,000 Lekë në muaj

### 2. Renditja e Propozuesve (Lista 4 e rishikuar)

Emri i Propozuesit	Çmimi i Enfiteozës së ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë, prej 288,000 Lekë në muaj	Renditja
Shoqëria “Xhenis - SH”	1,500,000	1
Shoqëria “Soleil & Sea” shpk	1,500,000	2
Bashkim Subjektsh shoqëria “2A Group” shpk, “Practica Arquitectura y Urbanismo SLP”, “Braclay	297,444	3

### 3. Si të bëni një ankesë

**AFATI:** Afati i fundit për dorëzimin e një ankesë lidhur me konkurimin që kundërshton vendimin për lidhjen e kontratës skadon në mesnatë, **18 Qershor 2025**, ora lokale.

Jepni emrin e kontratës, emrin e Propozuesit, detajet e kontaktit; dhe adresoni ankesën lidhur me konkurimin si më poshtë:

Në vëmendje: Njësia e Trajtimit të Ankesave

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa e emailit: competition@aicorporation.al

Në këtë pikë të procesit të konkurimit, ju mund të paraqisni një ankesë lidhur me konkurimin duke kundërshtuar vendimin për lidhjen e kontratës. Ju nuk keni nevojë të keni kërkuar ose marrë një informim para se të bëni këtë ankesë. Ankesa juaj duhet të dorëzohet dhe të merret nga ne përpara përfundimit të periudhës së ankimimit.

#### Informacione të mëtejshme:

Për më shumë informacion, shihni rregulloren përkatëse të procedurave konkurruese të Korporatës. Ju duhet t'i lexoni këto dispozita përpara se të përgatitni dhe paraqisni ankesën tuaj.

Në përmbledhje, ekzistojnë katër kërkesa thelbësore:

1. Ju duhet të jeni një 'palë e interesuar'. Në këtë rast, kjo do të thotë se ju jeni një Propozues i cili ka dorëzuar një propozim në këtë konkurim, dhe jeni marrësi i një Njoftimi paraprak për lidhjen e kontratës.
2. Ankesa mund të kundërshtojë vetëm vendimin për lidhjen e kontratës.
3. Ju duhet të paraqisni ankesën brenda afatit të lartpërmendur.
4. Ju duhet të përfshini, në ankesën tuaj, të gjithë informacionin e kërkuar nga rregulloren përkatëse të procedurave konkurruese të Korporatës.

### 4. Periudha e ankimimit

Periudha e ankimimit zgjat shtatë (7) ditë pas datës së transmetimit të këtij Njoftimi paraprak për lidhjen e kontratës. Periudha e ankimimit mund të zgjatet. Nëse kjo ndodh, ne do t'ju njoftojmë për zgjatjen.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Njoftim, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.